



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:133027
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05634101

CAP.nr.1216/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren individuale Hidajete Gashi Alaj, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit J.K kundër debitorit R.N, në bazë të dokumentit përmbartimor, Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.647/12, i datës 05.02.2012, i plotfuqishëm me datë 20.06.2013, baza juridike pengim posedim, duke vendosur në lidhje me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë –Departamenti i Përgjithshëm, E.nr.1185/13, i datës 04.05.2023 me datë 26.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit R.N, nga nfishati ..., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë –Departamenti i Përgjithshëm, E.nr.1185/13, i datës 04.05.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin E.nr.1185/13, i datës 04.05.2023 ka vendosur:

“NDËRPREHET procedura në çështjen përmbartimore të kreditorit J.K nga fshati ..., Komuna Pejë, për shkak të vdekjes së kreditorit J.K

Procedura përmbartimore e ndërprerë mund të vazhdohet kur trashëgimtarët apo personat e interesuar do të propozojnë që kreditorit J.K ti caktohet përfaqësuesi i përkohshëm”

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim

që ankesa të aprovohet në tërësi si e bazuar ndërsa aktvendimi i ankimuar që mbetet në fuqi mbi ndërprerjen e procedurës e deri në përfundimin e procedurës trashëgimore të kreditorit.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se :

-Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori me datën 13.08.2013, ka paraqitur propozim pranë Gjykatës Themelore në Pejë në bazë të aktvendimit të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm.

Gjykata Themelore në Pejë ka lejuar përmbartimin e aktvendimin, E.nr.1185/13, i datës 29.11.2013.

Pala debitore pas pranimit të aktvendimit për përmbartim, ka paraqitur prapësim me propozim që Gjykata ta aprovojë prapësimin dhe të shfuqizojë urdhrin për përmbartim.

Pas pranimit të prapësimin, Gjykata Themelore në Pejë ka refuzuar në tërësi prapësimin si të pa bazuar duke e lënë në fuqi aktvendimin për caktimin e përmbartimit.

Pas pranimit të aktvendimit pala debitorë ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit e cila me aktvendimin, Ac.nr.441/14, i datës 20.06.2014 e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e debitorit duke e vërtetuar aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Themelore në Pejë me aktvendimin, E.nr.1185/13, i datës 04.05.2023 e ka ndërprerë procedurën duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit ka theksuar se për shkak të vdekjes së kreditorit Gjykata e ka ndërprerë procedurën duke iu referuar dispozitës së nenit 277 par.1 pika a e lidhur me nenin 17 të LPP-së.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjyqtari i Gjykatës së Apelit e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale.

Pretendimet e debitorit se aktvendimi i ankimuar është i përfshirë në parashkrim të në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) e LPK-së, por sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit këto pretendime nuk qëndrojnë pasi që dispozitivi i aktvendimit është mjaft i qartë e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Tutje debitori në ankesë ka theksuar se në këtë çështje Gjykata ka qenë dashur të kërkojë aktvdekjen nga e cila do të vërtetohej se kush janë trashëgimtarët e të ndjerit, dhe se procedura duhet të mbetet e ndërprerë derisa trashëgimtarët të sjellin aktvdekjen për të ndjerin e nga e cila do të vërtetohet edhe legjitimiteti aktiv i trashëgimtarëve e jo në prezencën e trashëgimtarëve potencial të caktohet përfaqësuesi i përkohshëm për pranimin e shkresave.

Gjykata e Apelit duke i vlerësuar pretendimet e mësipërme vlerëson se të njëjtat nuk qëndrojnë për më tepër nga përmbajtja e ankesës rezulton se pikërisht ajo çka ka kërkuar debitori me ankesë është vendosur me aktvendimin e atakuar, pasi që debitori ka theksuar se procedura duhet të mbetet e ndërprerë, çka realisht ka vendosur Gjykata e shkallës së parë pra ka ndërprerë procedurën, ndërsa çështja e caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm nuk qëndron pasi që Gjykata e shkallës së parë nuk ka caktuar përfaqësues të përkohshëm por ka ndërprerë procedurën dhe tejet në mënyrë të qartë ka sqaruar se lidhur me caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm do të vendosë pas plotfuqishmërisë së aktvendimit.

Në rastin konkret, kërkesa e debitorit që të ndërprehet procedura derisa të përfundojë procedura trashëgimore është e pa bazuar dhe Gjykata nuk mund të marrë një vendim të tillë pasi që procedura përmbartimore e parasheh se si duhet të veprohet në rastet kur vdes kreditori apo debitori.

Edhe pse Gjykata e shkallës së parë në arsyetim ka cituar dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore në rastin konkret kemi të bëjmë me çështje juridike përmbartimore për çka është dashur që të zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbartimore më saktësisht nenin 35 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *“3. Në rast të vdekjes së kreditorit që nuk ka përfaqësues me prokurë apo përfaqësues ligjor, secili nga trashëgimtarët apo personat e interesuar mund të propozojë që deri sa të zgjasë bashkësia trashëgimore, Gjykata me shpenzime të propozuesit t’ua emërojë përfaqësuesin e përkohshëm dhe ta vazhdojë procedurën. Gjykata mund të emërojë vetëm një person që nuk ka interes personal në konflikt me interesat e kreditorit, dhe përfaqësuesi i përkohshëm ka për detyrë të lënë në mirëbesim që të veprojë në interes të kreditorit. Personi i emëruar ka të drejtën që të refuzojë emërimin, dhe përmbartuesi në atë rast kanë të drejtën që të emërojë një zëvendësues. Gjykata do ta emërojë përfaqësuesin e përkohshëm brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, nga dita e parashtrimit të propozimit. Në rast se propozimi i këtillë i trashëgimtarit, apo personave të interesuar nuk parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e vdekjes së kreditorit, Gjykata e pezullon procedurën përmbartimore.”*

Andaj në rastin konkret, Gjykata e Apelit vlerëson se drejtë është vendosur kur është ndërprerë procedura dhe se nuk ka asnjë pengesë që të vazhdohet me caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, gjithmonë duke pasur parasysh zbatimin e drejtë të dispozitave të LPP-së.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:133027
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05634101

CAP.nr.1216/2024, me datë 26.04.2024

Gjyqtarja
Hidajete Gashi Alaj, d.v.